



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-07

**Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt**

**Vendosi:** Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith, III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 6 shtator 2021

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Urdhër në lidhje me Pikat e Rendit të Ditës së Konferencës Përgatitore për  
Prokurorin e Specializuar**

---

**Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

**Mbrojtësve të Hysni Gucatit**

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bauden

**Mbrojtësve të Nasim Haradinajt**

Tobi Kadman

Karl Bakli

**TRUPI GJYKUES II**,<sup>1</sup> në pajtim me nenet 40(2) dhe 40(4) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullat 116(1)-(2), 118 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), nxjerr këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 21 korrik 2021, Trupi Gjykses caktoi datat 1 dhe 2 shtator 2021 për mbajtjen e konferencës përgatitore për gjykimin dhe paraprakisht caktoi datat 8 dhe 9 shtator 2021<sup>2</sup> për mbajtjen e konferencës përgatitore për Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("ZPS"). Palët bënë të ditur disponueshmërinë e tyre për të dy konferencat.<sup>3</sup>
2. Më 1 dhe 2 shtator 2021, Trupi Gjykses mbajti konferencën përgatitore për gjykimin, gjatë së cilës, me anë të një urdhri gojor, caktoi datat 8 dhe 9 shtator 2021<sup>4</sup> për mbajtjen e konferencës përgatitore për ZPS-në.

## II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

3. Në përputhje me rregullën 116(2) të Rregullores, trupi gjykses mban një konferencë përgatitore për Prokurorin e Specializuar brenda tridhjetë (30) ditësh pas mbajtjes së konferencës përgatitore për gjykimin.
4. Në pajtim me rregullën 118 të Rregullores, në konferencën përgatitore për ZPS-në, pasi të ketë dëgjuar palët, trupi gjykses, ndër të tjera, mund: (i) të përcaktojë numrin

---

<sup>1</sup> F00263, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Trupit Gjykses II*, 15 korrik 2021.

<sup>2</sup> F00267, Trupi Gjykses, *Urdhër për Parashtrime dhe për Caktimin e Datave për Mbajtjen e Konferencës Përgatitore për Gjykimin*, 21 korrik 2021.

<sup>3</sup> CRSPD51, *Mesazh Elektronik i NJAGJ-së drejtuar Dhomave në lidhje me Datën e Mbajtjes së Konferencës Përgatitore për Gjykimin*, 19 korrik 2021, konfidencial.

<sup>4</sup> Urdhër Gojor për Caktimin e Datës së Mbajtjes së Konferencës Përgatitore për ZPS-në, 2 shtator 2021, transkripti, faqja 604, rreshti 21 deri në faqen 604, rreshti 23.

e dëshmitarëve që ZPS-ja mund të thërrasë dhe të udhëzojë ZPS-në të heqë dëshmitarët përsëritës; (ii) të ftojë ZPS-në që të pakësojë numrin, ose të zvogëlojë kuadrin e akuzave; (iii) të përcaktojë kohën në dispozicion të ZPS-së për paraqitjen e provave; (iv) t'i kërkojë ZPS-së që të shkurtojë kohëzgjatjen e përllogaritur të pyetjeve për cilindo dëshmitar të identifikuar në listën e dëshmitarëve të ZPS-së sipas rregullës 95(4)(b); dhe (v) të verifikojë nëse palët kanë plotësuar detyrimet për nxjerrjen e materialit. Pasi merr njoftim në kohë dhe i tregohen arsye të vlefshme, trupi gjykues mund të lejojë ndryshimin e listës së dëshmitarëve dhe listës së provave materiale të ZPS-së. Trupi gjykues cakton datën për hapjen e çështjes të cilën e bën publike, e cila është brenda tridhjetë (30) ditësh pas mbajtjes së konferencës përgatitore për ZPS-në. Pasi të ketë dëgjuar palët dhe duke marrë parasysh dosjet paraprake, kryegjykatësi i trupit gjykues shënon pikat faktike dhe ligjore për të cilat palët pajtohen. Gjithashtu, trupi gjykues cakton një datë të parashikuar për përfundimin e paraqitjes së provave prej ZPS-së dhe, në qoftë se është e mundshme, për mbylljen e çështjes, përkatësisht sipas rregullave 129 dhe 136 të Rregullores.

### III. VENDIM

5. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues vendos që në pikat e rendit të ditës së konferencës përgatitore për ZPS-në të përfshihen çështjet e mëposhtme:

- a. trajtimi i çështjeve aktuale në lidhje me nxjerrjen e provave, duke përfshirë ato që kanë lidhje me njoftimin e hollësishëm të përditësuar sipas rregullës 102(3);
- b. shënimi i pikave faktike dhe ligjore për të cilat palët pajtohen, dhe, në lidhje me këtë:
  - i. dëgjimi i parashtrimeve të palëve lidhur me elementet e veprave penale dhe format e përgjegjësisë penale, siç paraqiten në Aktakuzë; dhe

- ii. trajtimi i parashtrimeve të Mbrojtjes lidhur me jurisprudencën përkatëse, përkufizimet dhe legjislacionin e propozuar, siç u urdhërua nga Trupi Gjykues më 2 shtator 2021<sup>5</sup>;
- c. përcaktimi i numrit të dëshmitarëve të ZPS-së dhe dëgjimi i parashtrimeve të Mbrojtjes në lidhje me kërkesën e ZPS-së për të shtuar një dëshmitar në listën e saj;
- d. përcaktimi i kohës në dispozicion të ZPS-së për paraqitjen e provave të saj;
- e. përcaktimi i datës për hapjen e çështjes dhe, në lidhje me këtë, marrja e informacionit nga Mbrojtja nëse dëshiron që me atë rast Prokurori i Specializuar të lexojë të gjithë Aktakuzën apo vetëm akuzat;
- f. marrja e një vlerësimi nga ZPS-ja në lidhje me kohëzgjatjen e deklaratës hyrëse të saj dhe kërkimi i një konfirmimi nga Mbrojtja se ajo zgjedh të bëjë një deklaratë hyrëse vetëm në fund të paraqitjes së provave nga ZPS-ja dhe para fillimit të paraqitjes së provave të saj, nëse ka;
- g. përcaktimi i një kalendari paraprak për paraqitjen e provave nga ZPS-ja;
- h. përcaktimi i datave të parashikuara për përfundimin e paraqitjes së provave nga ZPS-ja dhe, në qoftë se është e mundshme, për mbylljen e çështjes sipas rregullës 136 të Rregullores; dhe
- i. çdo çështje tjetër e ngritur nga palët dhe çdo çështje tjetër e re që Trupi Gjykues mund të dëshirojë ta trajtojë.

/nënshkrimi/

**Gjykatës Çarls L. Smith, III**  
**Kryegjykatës**

---

<sup>5</sup> Urdhër Gojor për Parashtrime nga Mbrojtja, 2 shtator 2021, transkripti, f. 601, rreshti 17 deri në faqen 602, rreshti 10.

E hënë, 6 shtator 2021  
Në Hagë, Holandë.